3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

Blerina Zogaj, ka parashtruar kërkesën 10Nr.-553-12839 të datës 04.04.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërimin e djalit nga epilepsia.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Leart Mehmeti është i sëmur nga epilepsia si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë jashtë vendit të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërimin e djalit dhe përkrahet me mjete financiare në shumë prej **250.00€(dyqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e saj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

#### Vendimi t'i dërgohet:

- Blerina Zogaj,
- Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës  
z.Illir FERATI




|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-293/022</b>                                                         | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>16.05.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nën 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 10 Nr.-553-4423 të datës 01.02.2022 të parashtruar nga Kaltrina Ahmetaj, nga fsh. Banjë, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e vajzës Lelja Ahmetaj, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 10Nr.553-4423 e datës 01.02.2022, e parashtruar Kaltrina Ahmetaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e vajzës dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **250.00€(dyqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës për Komunitete dhe Kthim si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Kaltrina Ahmetaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

Kaltrina Ahmetaj, ka parashtruar kërkesën 10Nr.-553-4423 të datës 01.02.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për shërimin e vajzës vërehet një deformim i këmbës së djathtë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe Fletëleshimi i mjekëve në Repartin e Neonatologjisë shihet se Lelja Ahmetaj ka një deformimet të këmbës së djathtë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për shërimin e saj dhe blerja e terapisë është mjaftë të kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërimin e vajzës dhe përkrahjet me mjete financiare në shumë prej **250.00€(dyqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Kaltrina Ahmetaj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

**Vendimi t'i dërgohet:**

- Kaltrina Ahmetaj,
- Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**znj.Zekije SUTAJ**



**Kryetari i Komunës**  
**z. Ilir FERATI**

27



|                                                                                                                                                    |                                                                                         |                                                          |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                          | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | <b>Nr.Br. 01-331/2022</b>                                                               | <b>Data:<br/>         Datum:<br/>         17.05.2022</b> |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 08Nr.182/2022 të datës 12.05.2022 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike për themelimin e Grupit punues për hartimin e Draft Planit të veprimit për Energji dhe Klimë të Qëndrueshme, i propozon Kryetarit të nxjerr:

## V E N D I M

1. **THEMELOHET:** Grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit për Energji dhe Klimë të Qëndrueshme dhe në grupin punues caktohen:

- 1.1. **Abedin Kabashi**, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Kryesues i Grupit punues,
- 1.2. **Isa Hoxhaj**, Zyrtar i Lartë për Eficiencë të Energjisë, Koordinator i Grupit punues,
- 1.3. **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar,
- 1.4. **Rexhep Blakaj**, Udhëheqës i Sektorin për Urbanizëm, anëtar,
- 1.5. **Elfete Blakaj**, Udhëheqëse e Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit, anëtare,
- 1.6. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar,
- 1.7. **Besnik Metaj**, Zyrtar i Lartë për Tatimin në Pronë, anëtar,
- 1.8. **Sami Metaj**, Zyrtar i Lartë Ligjor, anëtar,
- 1.9. **Arta Fetahaj**, Zyrtare për Planifikim dhe Zhvillim, anëtare,
- 1.10. **Blerim Bujupaj**, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar,
- 1.11. **Valbone KalIQani**, Zyrtare e Lartë për Pemëtari, anëtare.

2. Grupi punues i lartcekur obligohet që punës t'ia filloj menjëherë për hartimin e Planit të Veprimit për Energji dhe Klimë të Qëndrueshme; do të del në terren për mbledhjen e të dhënave; do të njoftoj Kryetarin e Komunës me punën gjatë hartimit të PVEKQ; pas përfundimit të planit do t'ia dërgoj Kryetarin një kopje si dhe do ti kryej punët dhe përgjegjësit tjera që janë në natyrën e këtij grupi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Grupi Punues dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Vendimi është përfundimtar.

### Vendimi t' i dërgohet:

- Grupit Punues,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
 znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës  
 z. Ilir FERATI



|                                                                                                                                                    |                                                                                         |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-334/022                                                                       | Data:<br>Datum:<br>20.05.2022 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-18419 të datës 12.05.2022 të parashtruar nga znj.Aferdita Zeqiraj, nga fsh. Lubozhdë, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e saj, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-18419 e datës 12.05.2022, e parashtruar nga **znj.Aferdita Zeqiraj**, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€(njëqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Aferdita Zeqiraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

Aferdita Zeqiraj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.-553-18419 të datës 12.05.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Aferdita është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe përkrahet me mjete financiare në shumë prej **150.00€(njëqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e saj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

**Vendimi t'i dërgohet:**

- Aferdita Zeqiraj,
- Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
 znj.Zekije SUTAJ





|                                                                                                                                                    |                                                                                         |                                                          |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                          | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | <b>Nr.Br. 01-335/2022</b>                                                               | <b>Data:<br/>         Datum:<br/>         20.05.2022</b> |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47, dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-19481 të datës 18.05.2022, të parashtruar nga z.Islam Osmanaj nga fsh. Kaliqan, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes Ganimete Osmanaj për rrezatime në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-19481 e datës 18.05.2022, e parashtruar nga **z.Islam Osmanaj** për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes për rrezatime në QKUK në Prishtinë dhe i lejohen **300 litra karburant** për një muaj.
2. Obligohet Zyrtari i transportit që të pajisë z.Islam Osmanaj, për çdo javë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit deri në përfundimin e rrezatimit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

### A r s y e t i m

z.Islam Osmanaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-19481 të datës 18.05.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i bashkëshortes së tij Ganimete Osmanaj në QKUK- Prishtinë për rrezatime.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Ganimete Osmanaj është e sëmurë dhe ka nevojë për rrezatime sipas raportit të lëshuar nga QKUK dhe i ndihmohet me 300 litra karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për rrezatime në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri është në gjendjen ekonomiko sociale jo të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për rrezatime në Prishtinë.

Zyrtari i transportit Islamin do të pajisë për çdo javë me vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

**Vendimi t'i dërgohet:**

- z.Islam Osmanaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
 znj. Zekije SUTAJ



|                                                                                                                                                    |                                                              |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | KRYETARI I KOMUNËS<br>PREDSIEDNIK OPŠTINE<br>MUNICIPAL MAYOR |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-336/2022                                           | Data:<br>Datum:<br>20.05.2022 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 19.05.2022, për caktimin e Grupit të menaxherëve të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të menaxherëve të kontratës për projektin: “Ndërtimi Qëndres së Istogut”, rruga “Ibrahim Rugova”, “Fadil Ferati” dhe UÇK (projekt 3 vjeçar) nxjerr:

## V E N D I M

**1. CAKTOHET:** Grup i menaxherëve të kontratës **1.Dukagjin Hoxhaj**–Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis; **2.Naser Nimanaj**-Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore; **3.Agon Dreshaj**, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër dhe **CAKTOHET:** Mbikëqyrës i drejtpërdrejt i Grupit të menaxherëve të kontratës **Genc Ademaj**, Drejtor Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim për projektin: “Ndërtimi Qëndres së Istogut”, rruga “Ibrahim Rugova”, “Fadil Ferati” dhe UÇK (projekt 3 vjeçar) me numër të jashtëm prokurimi 633-019-7893-5-1-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-019-093-511 të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori “Granit” SH.P.K.

2. Grupi i menaxherëve të kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i menaxherëve të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.

3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Grupi i Menaxherëve të kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i menaxherëve të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi është përfundimtar.

### Vendimi t'i dërgohet:

- Grupit të menaxherëve të kontratës,
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt i menaxherëve të kontratës,
- Prokurimit,
- Drejtoris së Planifikimit Urban dhe Mjedis,
- “Granit” SH.P.K, Operatori dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
 znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës  
 Zyrtar Kryesor Administrativ  
 z.Illir FERATI



|                                                                                                                                                                         |                                                                                 |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PRESDENIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-338/022</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>20.05.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.553-18878 të datës 16.05.2022 të parashtruar nga znj.Nebahate Zeqiraj, nga fsh..Prigodë, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e saj, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 01 Nr.553-18878 të datës 16.05.2022 të parashtruar nga znj.Nebahate Zeqiraj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **300.00€(treqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Nebahate Zeqiraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

Nebahate Zeqiraj, ka parashtruar kërkesën 01 Nr.553-18878 të datës 16.05.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Nebahatja është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapinë për shërim dhe përkrahet me mjete financiare në shumë prej **300.00€(treqind euro)**.

Në plan programin buxhetor i Zyrës Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e saj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

**Vendimi t'i dërgohet:**

- Nebahate Zeqiraj,
- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
znj.Zekije SUTAJ



|                                                                                                                                                    |                                                              |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | KRYETARI I KOMUNËS<br>PREDSIEDNIK OPŠTINE<br>MUNICIPAL MAYOR |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-340/022                                            | Data:<br>Datum:<br>23.05.2022 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.-553-19381 të datës 18.05.2022 të parashtruar nga Albana Prekaj-Demaj nga Banjë, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e saj, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 01 Nr.553-19381 e datës 18.05.2022 e parashtruar nga Albana Prekaj-Demaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **390.00€(treqind e nëntëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Albana Prekaj-Demaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

Albana Prekaj-Demaj, ka parashtruar kërkesën 01 Nr.-553-19381 të datës 18.05.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Albana është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë e cila është mjaftë e kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **390.00€(treqind e nëntëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e saj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

**Vendimi t'i dërgohet:**

- Albana Prekaj-Demaj,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
 znj.Zekije SUTAJ




|                                                                                                                                                                         |                                                                                   |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠHTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-346/022</b>                                                          | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>24.05.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), nenin 10 paragrafi 4 nenin 11 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.13/2019), nenin 21 dhe 26 të Ligjit 05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 31 të Statutit të Komunës së Istogut Nr.62/2010 i datës 30.11.2010, Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike shqyrtoj kërkesën 01-034-20174 të datës 23.05.2022 të parashtruar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) me seli në Prishtinë, i propozon verbalishtë Kryetarit të nxjerr:

### V E N D I M

#### Për qasje në dokumente publike.

**1. MIRATOHET:** kërkesa 01-034-20174 e datës 23.05.2022 e parashtruar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), si e bazuar për qasje në dokumente publike dhe i lejohet qasja e plotë në dokumentet që janë kërkuar, për kryerjen e hulumtimeve dhe analizave me qëllim të krijimit të ambientit të favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile, si me poshtë:

- 1.1. Listën e përgjithshme e pronave të paluajtshme të komunës për vitin 2021,
  - 1.2. Të gjitha njoftimet publike të shpallura në vitin 2021 për shprehjen e interesit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për:  
Shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës prej 1 deri në 15 vite;  
Shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës prej 15 deri në 99 vite;  
Shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në afat ma pak se një vit.
  - 1.3. Të gjitha njoftimet publike të shpallura në vitin 2021 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për:  
Shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës prej 1 deri në 15 vite;  
Shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës prej 15 deri në 99 vite;  
Shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në afat ma pak se një vit.
2. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.
3. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), ka parashtruar kërkesë 01-034-20174 të datës 23.05.2022 për qasje në dokumente publike, për kryerjen e hulumtimeve dhe analizave me qëllim të krijimit të ambientit të favorshëm për zhvillim të shoqërisë civile, që është kërkuar: Lista e përgjithshme e pronave të paluajtshme të komunës për vitin 2021; Të gjitha njoftimet publike të shpallura në vitin 2021 për shprehjen e interesit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për: Shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës prej 1 deri në 15 vite; Shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës prej 15 deri në 99 vite; Shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në afat ma pak se një vit. Të gjitha njoftimet publike të shpallura në vitin 2021 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për: Shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës prej 1 deri në 15 vite; Shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës prej 15 deri në 99 vite; Shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në afat ma pak se një vit. Zyrtarja për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike ka shqyrtuar kërkesën si të bazuar dhe pas analizimit dhe vlerësimit të kërkesës i propozoj verbalishtë Kryetarit të vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi. Kryetari e shqyrtoj propozimin verbal të Zyrtares për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe e miraton lejimin e qasjes në dokumente publike si në pikën 1 të këtij Vendimi

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 ditëve nga data e pranimit të tij.

#### Vendimi t'i dërgohet:

- Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF),
- Jeta Balaj-Imeraj-Zyrtare për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
znj. Zekije SUTAJ



|                                                                                                                                                    |                                                                                       |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PRESDENIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-347/2022                                                                    | Data:<br>Datum:<br>24.05.2022 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, për themelimin e Komisionit për regjistrimin e shfrytëzuesve të zyrave në shtëpinë e kulturës "Adem Jashiri" në Istog, nxjerr:

## V E N D I M

**1. THEMELOHET:** Komisioni për regjistrimin e shfrytëzuesve të zyrave në shtëpinë e kulturës "Adem Jashiri" dhe në komision caktohen:

|                                                                                                                                                    |                                                                                         |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosovo | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01- <del>360</del> /022                                                          | Data:<br>Datum:<br>27.05.2022 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-16285 të datës 27.04.2022 të parashtruar nga Rrahime Lipaj nga fsh. Studenicë nga Istogu për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e saj, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-16285 e datës 27.04.2022, e parashtruar nga **Rrahime Lipaj** për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **200.00€(dyqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Rrahime Lipaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: dhe Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

Rrahime Lipaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-16285 të datës 24.04.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Rrahimja është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaft të kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike-pensioniste dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapinë për shërim të cilat janë shumë të kushtueshme dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **200.00€(dyqind euro)**.

Në plan programin buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e saj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

**Vendimi t'i dërgohet:**

- Rrahime Lipaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
 znj.Zekije SUTAJ

*[Signature]*



|                                                                                   |                                                                       |                                        |                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
|  | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                        |  |
| <b>Republika e Kosovës<br/>Republika Kosovo<br/>Republic of Kosova</b>            | <b>Nr.Br. 01-361/022</b>                                              | <b>Data:<br/>Datum:<br/>27.05.2022</b> | <b>Komuna e Istogut<br/>Opština Istok<br/>Istog Municipality</b>                    |

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-17446 të datës 06.05.2022 të parashtruar nga Mehmet Ibishi nga Istogu për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-17446 e datës 06.05.2022, e parashtruar nga **Mehmet Ibishi**, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€(njëqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Mehmet Ibishit, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: dhe Drejtoria për Shëndetësi.
4. Vendimi është përfundimtar.

### A r s y e t i m

Mehmet Ibishi, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-17446 të datës 06.05.2022, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Mehmeti është person me aftësi të kufizuara, i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapinë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00€(njëqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

**Vendimi t'i dërgohet:**

- Mehmet Ibishi,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës  
z. HIR FERATI



|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br.01-362/2022</b>                                                         | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>27.05.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 26.05.2022, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës për projektet: Lot1“Furnizimi me dokumente mjekësore” Lot2 “Servisimi dhe riparimi i rëntgenit”, nxjerr:

## V E N D I M

- 1. CAKTOHET:** Menaxher i Kontratës **z.Kastriot Idrizaj**, Zyrtar i të hyrave në QKMF dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës **z.Zenel Shatri**, Drejtorë i Drejtorisë për Shëndetësi për projektet: Lot 1 “Furnizimi me dokumente mjekësore” Lot 2 “Servisimi dhe riparimi i rëntgenit”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-2448-1-2-1 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-008-121, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori **“G.I.Grafo-Loni” SH.P.K.**
- Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës obligohet që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
- Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.
- Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
- Vendimi është përfundimtar.

### **Vendimi t'i dërgohet:**

- Kastriot Idrizaj, Zyrtar i të hyrave në QKMF,
- Zenel Shatri, Drejtorë i Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**znj.Zekije SUTAJ**




|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PREDSEDNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-363/2022</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>27.05.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008) nenit 24 të Rregullores (QRK)-Nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme dhe bazuar në nenin 73 të Statutit të Komunës 01Nr.62/2010 i miratuar në Kuvendin e Komunës me datë të 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 10 Nr.18/2022 të datës 26.05.2022 të parashtruar nga Udhëheqësi i Zyrës Komunale Për Komunitete dhe Kthim për themelimin e komisionit komunal për kthim dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

## V E N D I M

**1. THEMELOHET:** Komisioni Komunal për Kthim në përbërje prej 8 anëtar të institucioneve si në vijim:

- 1.1. **Rasim Mahmutović**, Udhëheqës i ZKKK-së, Kryesues i komisionit,
- 1.2. **Valentina Alihajdaraj**, Drejtorja Komunale për Arsim,
- 1.3. **Brahim Hetemaj**, Drejtorja për Shëndetësi, anëtar,
- 1.4. **Mahije Bujupaj**, Drejtorja për Mirëqenie Sociale, anëtare,
- 1.5. **Blerim Bujupaj**, Drejtorja për Shërbime Publike, anëtar,
- 1.6. **Elfete Blakaj**, Drejtorja për planifikim Urban dhe Mjedis, anëtare,
- 1.7. **Bushat Gashi**, Drejtorja për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar,
- 1.8. **Aleksander Đekić**, përfaqësues i MKK-së, anëtar.

2. Komisioni Komunal për Kthim është organ rekomandues për rastet si në nenin 24 paragrafi 1 i Rregullores (QRK)-Nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme.

3. Mandati i anëtarëve të Komisionit caktohet në periudhë 3 vjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një mandati shtesë.

4. Komisioni Komunal për Kthim mbledhet të paktën një herë në muaj, si dhe me kërkesë nga ana e udhëheqësit të ZKKK-së, në konsultim me anëtarët e tjerë.

5. Komisioni Komunal për Kthim merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm ku në rast të votave të barabarta, vendos vota e kryesuesit dhe i rekomandon rastet për vendim tek Komisioni Qendror Shqyrtues.

6. Tek projektet bilaterale çështja e pjesëmarrjes dhe roli i përfaqësuesit në Komisionin Komunal për Kthim nga radhët e donatorit rregullohet me marrëveshje në mes MKK-së, komunës dhe donatorit.

7. UNHCR-ja ka rol këshillues në Komisionin Komunal për Kthim.

8. Komisioni Komunal për Kthim është i hapur për organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare për qëllime të monitorimit.

9. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe për zbatimin e tij kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Komisioni Komunal për Kthim.

10. Vendimi është përfundimtar.

### Vendimi i dërgohet:

- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Komisionit Komunal për Kthim dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**znj. Zekije SUTAJ**




**Kryetari i Komunës**  
**z. Ilir FERATI**



|                                                                                                                                                    |                                                                                         |                                                          |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                          | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | <b>Nr.Br. 01-364/2022</b>                                                               | <b>Data:<br/>         Datum:<br/>         30.05.2022</b> |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-9241 të datës 08.03.2022, të parashtruar nga z.Esat Demaj nga Vrellë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e djalit Erion Demaj për trajtim me kimioterapi në kliniken e Pediatriisë në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

### V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-9241 E datës 08.03.2022, e parashtruar nga z.Esat Demaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e djalit Erion Demaj për trajtim me kimioterapi në kliniken e Pediatriisë në QKUK në Prishtinë dhe i lejohen **280 litra karburant**.
2. Obligohet Zyrtari i transportit që të pajisë Esat Demaj me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit deri në përfundimin e trajtim me kimioterapi si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

### A r s y e t i m

z.Esat Demaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-9241 të datës 08.03.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i djalit në QKUK në Prishtinë për trajtim me kimioterapi.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Erion Demaj është i sëmurë dhe ka nevojë për rrezatime sipas raportit të lëshuar nga QKUK dhe i ndihmohet me 280 litra karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për rrezatime në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri është në gjendjen ekonomiko sociale jo të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për rrezatime në Prishtinë.

Zyrtari i transportit Islamini do të pajisë për çdo javë më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare.

Drejtorja për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

**Vendimi i dërgohet:**

- z.Esat Demaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
 znj. Zekije SUTAJ





|                                                                                                                                                    |                                                                       |                               |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>MUNICIPAL MAYOR</b> |                               | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | Nr.Br. 01-365/2022                                                    | Data:<br>Datum:<br>30.05.2022 |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008) dhe bazuar në nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e datës 30.05.2022 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike për themelimin e Grupit punues për hartimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2027 dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

## V E N D I M

1. **THEMELOHET:** Grupit punues për hartimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2027 dhe në grupin punues caktohen:

- 1.1. **Abedin Kabashi**, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, Kryesues i Grupit punues,
- 1.2. **Naser Gjocaj**, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, Koordinator i Grupit punues,
- 1.3. **Zekije Sutaj**, Udhëheqës i Sektorit Ligjor, anëtare,
- 1.4. **Elfete Blajkaj**, Udhëheqës i Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit, anëtare,
- 1.5. **Skender Hasangjekaj**, Udhëheqës i Sektorit për Emergjecë, anëtar,
- 1.6. **Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar,
- 1.7. **Burbuqe Pepaj**, Inspektore e Ndërtimit, anëtare,
- 1.8. **Isa Hoxhaj**, Zyrtar i Lartë për Eficiencë të Energjisë, anëtar,
- 1.9. **Fadil Kabashi**, Udhëheqës i Sektorit për Bujqësi, anëtar,
- 1.9. **Alferd Tahirsylaj**, Menaxher i NP "Ambienti", anëtar,
- 1.10. **Xhevdet Zekaj**, Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët, anëtar,
- 1.11. **Abedin Neziraj**, Zyrtar për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komuniteteve, anëtar,

2. Grupi punues i lartcekur obligohet që punës t'ia filloj menjëherë për hartimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2022-2027; do të del në terren për mbledhjen e të dhënave; do të njoftoj Kryetarin e Komunës me punën gjatë hartimit të PKMM; pas përfundimit të planit do t'ia dërgoj Kryetarin një kopje si dhe do ti kryej punët dhe përgjegjësit tjera që janë në natyrën e këtij grupi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Grupi Punues dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

4. Vendimi është përfundimtar.

### Vendimi t'i dërgohet:

- Grupit Punues,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
znj. Zekije SUTAJ




|                                                                                                                                                    |                                                                                          |                                      |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠHTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                                      | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | <b>01 Nr.366/2022</b>                                                                    | <b>Data:<br/>         30.05.2022</b> |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 67 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë Komunale për Arsim 05.Nr.370/2022 të datës 27.05.2022, për kompenzimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Smajl Sejdiqaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Historisë-Gjeografisë, në SHFMU “Bajram Curri” në Istog, nxjerr:

### V E N D I M

**1. MIRATOHET:** kërkesa 05.Nr.370/2022 e datës 27.05.2022, e parashtruar nga Drejtoria Komunale për Arsim për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Smajl Sejdiqaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Historisë-Gjeografisë, në SHFMU “Bajram Curri” në Istog.

**2.** Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **12.06.2022**.

**3.** Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.

**4.** Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë Komunale për Arsim, obligohet që Smajl Sejdiqaj, t'ia bëjë pagesën e 3(tri) pagave mujore që i ka marr për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

**5.** Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Inspektoratit të Punës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

#### Vendimi t'i dërgohet:

- Smajl Sejdiqaj,
- Drejtorisë Komunale për Arsim,
- Zyrtarit Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor  
 znj.Zekije SUTAJ




|                                                                                                                                                                         |                                                                                  |                                                    |                                                                                                                                                                     |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br><b>Republika Kosovo</b><br><b>Republic of Kosova</b> | <b>KRYETARI I KOMUNËS</b><br><b>PRESDENNIK OPŠTINE</b><br><b>MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                    | <br><b>Komuna e Istogut</b><br><b>Opština Istok</b><br><b>Istog Municipality</b> |
|                                                                                                                                                                         | <b>Nr.Br. 01-367/2022</b>                                                        | <b>Data:</b><br><b>Datum:</b><br><b>31.05.2022</b> |                                                                                                                                                                     |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 61 paragrafi 61.27, 61.28, 61.29, 61.30 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.88/2022 të datës 20.04.2022 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi si dhe kërkesa e datës 09.05.2022 të parashtruar nga organi mbikëqyrës “P.M.N” SH.P.K, për ndërprerjen e kontratës për mos përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontrata për projektin: Lot 3 “Trasimi i rrugës rurale dhe kanalit të ujitjes në Muzhevinë”, nxjerr:

### V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa Nr.88/2022 e datës 20.04.2022 e parashtruar nga i Drejtori Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe kërkesa e datës 09.05.2022 e parashtruar nga organi mbikëqyrës “P.M.N” SH.P.K. për ndërprerjen e kontratës për mos përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontratat për projektin: Lot 3 “Trasimi i rrugës rurale dhe kanalit të ujitjes në Muzhevinë” me numër të jashtë prokurimi 623-20-4978/5-2-1/C382 dhe numër të brendshëm prokurimi 633/020/069 /521 të cilin ka fituar për ta realizuar operatori “ALFA.I” SH.P.K.
- 2. Obligohet Zyra e Prokurimit të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme bazuar në dispozitat ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratave si në piken 1 të këtij vendimi.**
- 3. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm menjëherë pas nënshkrimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe obligohet: Prokurimi të zbatohet.**

### A r s y e t i m

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, ka parashtruar kërkesën 09 Nr.88/2022 të datës 20.04.2022 si dhe organi mbikëqyrës “P.M.N” SH.P.K ka parashtruar kërkesën e datës 09.05.2022 për ndërprerjen e kontratës për mos përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontrata për projektin: Lot 3 “Trasimi i rrugës rurale dhe kanalit të ujitjes në Muzhevinë” me numër të jashtë prokurimi 623-20-4978/5-2-1/C382 dhe numër të brendshëm prokurimi 633/020/069 /521 të cilin ka fituar për ta realizuar operatori “AFA.I” SH.P.K. Pas shqyrtimit të kërkesës ZKA-ja miraton kërkesën e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe kërkesën e organi mbikëqyrës “P.M.N” SH.P.K. e që e obligon Zyrën e Prokurimit që ti ndërmarr të gjitha masat e nevojshme sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

#### Vendimi t'i dërgohet:

- Gëzim Ademaj-Udhëheqës i Prokurimit,
- Drejtorja për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi
- “PMN” SH.P.K, organi mbikëqyrës dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**znj.Zekije SUTAJ**




|                                                                                                                                                    |                                                                                         |                                                          |                                                                                                                                                |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo<br>Republic of Kosova | <b>KRYETARI I KOMUNËS<br/>         PREDSIEDNIK OPŠTINE<br/>         MUNICIPAL MAYOR</b> |                                                          | <br>Komuna e Istogut<br>Opština Istok<br>Istog Municipality |
|                                                                                                                                                    | <b>Nr.Br. 01-368/2022</b>                                                               | <b>Data:<br/>         Datum:<br/>         31.05.2022</b> |                                                                                                                                                |

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të dhënave personale, dispozitat e Rregullores (QRK)-Nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme dhe bazuar në nenin 73 të Statutit të Komunës 01Nr.62/2010 i miratuar në Kuvendin e Komunës me datë të 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për caktimin zyrtarëve përgjegjës për qasje dhe regjistrimin e kërkesave në bazën e të dhënave në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, nxjerr:

#### VENDIM

**1. CAKTOHEN:** zyrtarët përgjegjës të cilët do të kenë qasje për regjistrimin e kërkesave në bazën e të dhënave të MKK-se si në vijim:

**1.1. Rasim Mahmutović,** Udhëheqës i ZKKK-së,

**1.2. Vesna Maliković,** Zyrtare për Kthim të Qëndrueshëm në ZKKK.

**2.** Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi do të jenë përgjegjës për pranimin e kërkesave dhe regjistrimin e tyre në bazën e të dhënave.

**3.** Obligohen zyrtarët përgjegjës të dhënat për personat e zhvendosur dhe të kthyerit ti trajtojnë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Rregullores (QRK)-Nr.01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdesen: Zyrtarët e caktuar dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.

**5.** Vendimi është përfundimtar.

#### Vendimi i dërgohet:

- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Komisionit Komunal për Kthim dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor**  
**znj. Zekije SUTAJ**



**Kryetari Komunës**  
**znj. Ilir FERATI**

